

TRAJNIMI I ARKIVISTËVE NË KOSOVË NGA FILLIMI I VITEVE '70 DERI NË DITËT E SOTME

Përmbledhje

Në këtë punim do të paraqes trajnimin e arkivistëve në Kosovë që nga fillimi i funksionimit të shërbimit arkivor në vitet '70 deri në ditët e sotme. Me anë të këtij punimi do të elaboroj metodat që janë përdorur ndër vite dhe ato që përdoren aktualisht për aftësimin dhe përgatitjen e arkivistëve në vend. Punëtorët janë shtylla kryesore e çdo organizate. Trajnimi i punëtorëve zë vend shumë të rëndësishëm pasi që ndikon drejtpërdrejt në ngritjen e performancës në punë. Për ta realizuar qëllimin e këtij punimi do të përdor metoda kualitative të hulumtimit, duke u mbështetur në burimet parësore dhe dytësore të të dhënave dëshmuese, me anë të të cilave do të argumentohet se, pavarësisht prej rrethanave dhe situatës në të cilën kaloi Kosova, mund të thuhet se është arritur të krijohen kuadro profesionale arkivore në vendin tonë.

Fjalë kyçe: *arkiva, arkivistika në Kosovë, edukimi, trajnimi*

ARCHIVISTS EDUCATION AND TRAINING IN KOSOVO FROM THE 70's TO TODAY

Abstract

In this paper I will present the training of archivists in Kosovo since the beginning of the functioning of the archival service in 70s until today. Through this paper I will elaborate the methods that were used through years and that are being used actually to train and prepare archivists in the country. Employees are the backbone of every organization, training is very important because it has a direct impact on raising employee performance. In order to achieve the purpose of this paper I will use the qualitative research method based on the primary and secondary sources of evidence, which will be used to argue that despite the circumstances in which Kosovo went through, it can be concluded that our country has managed to develop professional archival staff.

Keywords: *Archives, Archives in Kosovo, Education, Training*

Ngritja e shërbimit arkivor në Kosovë

Fillet e shërbimit arkivor në Kosovë datojnë që nga krijimi i Qendrës Arkivore në kuadër të Drejtorisë Krahinore për Arsim dhe Kulturë në vitin 1948. Vendimi i Këshillit Krahinor për Arsim dhe Kulturë i datës 20 mars 1951 mbi themelimin e Arkivit Shtetëror Krahinor krijon edhe kushtet e para për fillimin e funksionimit të shërbimit arkivor në Kosovë. Arkivi Shtetëror Krahinor, tani Arkivi i Kosovës, kreu funksionin e tij në tërë Kosovën deri në fund të viteve '60 kur u krijua rrjeti arkivor në baza ndërkomunale dhe komunale.¹

Pas themelimit Arkivi i Kosovës është përballë me dy probleme të mëdha: me mungesën të një objekti ideal për arkiv dhe të kuadrove të kualifikuara për arkivistikë. Si pasojë e këtyre problemeve institucioni i Arkivit të Kosovës filloi punën tre vjet më vonë, në vitin 1954, me vetëm dy punëtorë arkivorë në ndërtesën e bibliotekës së qytetit të Prishtinës.² Arkivi i Kosovës në dekadën e tij të parë të punës është transferuar disa herë në lokale të ndryshme gjë që ka vështirësuar punën e institucionit. Nga viti 1954 deri në vitin 1963 në Arkiv janë punësuar vetëm gjashtë punëtorë të cilët kanë qenë me strukturë të dobët dhe joadekuate kualifikuese.³

Pavarësisht prej vështirësive, Arkivi i Kosovës ka bërë përpjekje për ta afirmuar shërbimin arkivor përmes organizimit të “Javës së arkivave”, evidencimit të materialit regjistruar dhe lëndës arkivore të organizatave dhe pranimin e fondeve që kanë qenë të rrezikuara nga shkatërrimi. Arkivi i Kosovës ka vazhduar punën si i vetmi arkiv në vend deri në vitin 1968 kur kanë filluar të formohen arkivat ndërkomunale dhe komunale, shumica prej tyre me kushte minimale për punë.⁴ Fillimisht është krijuar Arkivi Ndërkomunal i Prizrenit, pastaj i Pejës, i Mitrovicës, i Gjilanit, i Prishtinës, Arkivi Historik i Gjakovës dhe Arkivi Komunal i Deçanit.⁵

Me zgjerimin e shërbimit arkivor në arkiva ndërkomunale ka filluar të rritet hovshëm edhe numri i të punësuarve. Kështu është paraqitur nevoja për krijimin e Shoqatës Profesionale Arkivore dhe më 23 nëntor 1968 është mbajtur Kuvendi i Parë Themelues, në të cilin është formuar Shoqata e Punonjësve Arkivorë të Kosovës.⁶ Përveç mbrojtjes së lëndës arkivore, përpunimit dhe shfrytëzimit, kjo Shoqatë ka punuar zellshëm

¹ Jusuf Osmani, *Arkivistika - teoria dhe praktika*, Prishtinë, 2005

² Ismet Dermaku, *Deset Godina Rada Pokrajniskog Državnog arbiva*, *Godišnjak*, nr. 1 (1965), f. 9-15

³ Jusuf Osmani, *Arkivat dhe zhvillimi i shërbimit arkivor në Kosovë*, *Vjetari*, nr. 24, 1988, f. 163-178

⁴ Po aty f. 163-178

⁵ Zaim Maqedonci, *Veprimtaria arkivore dhe detyrat e shërbimit amë të Arkivit të Kosovës*, *Vjetar*, nr. 2-3, 1970, f. 427-435

⁶ Iljaz Rexha, *Shoqata e Punëtorëve Arkivorë të Kosovës*, *Vjetar*, nr. 6-7, 1974, f. 292-293

edhe për arsimimin dhe aftësimin e stafit që punonte në arkiv dhe regjistatura. Një prej formave të aftësimit ishin këshillimet me punonjësit arkivorë dhe seminarët me përfaqësuesit e regjistraturave.⁷

Është e rëndësishme të ceket që kjo etapë kohore është shënuar edhe me themelimin e Universitetit të Prishtinës më 18 nëntor 1969, një ngjarje historike për të gjithë shqiptarët, po ashtu edhe për punonjësit arkivorë për të cilët është hapur një mundësi për të marrë një edukim të lartë profesional. Në kuadër të Universitetit të Prishtinës është themeluar Fakulteti Filozofik, në të cilin është hapur Dega e Historisë, e cila historikisht është e lidhur me zhvillimin e arkivistikës. Kështu që arkivistët nga Kosova që nga fillimi i viteve '70 kishin mundësi të studionin në gjuhën e tyre amtare në Prishtinë.⁸

Në vitin 1977 është inauguruar ndërtesa e Arkivit të Kosovës. Objekti i tij përbëhet prej dy pjesëve: pjesa punuese që ka rreth 3 000 m² sipërfaqe punë dhe depot e arkivit që kanë rreth 2000 m² sipërfaqe. Një objekt modern për kohën, i cili është pajisur me mjete të sofistikuara për punë dhe me laboratorin më modern në vend që shërbente për mikrofilmim, restaurim dhe konservim të lëndëve arkivore. Përveç ndërtimit të objektit të arkivit, përgjatë viteve '70 janë sistemuar në ndërtesa të veçanta edhe arkivat komunale në qytete të ndryshme në Kosovë.⁹

Problemi për të siguruar kuadro profesionale në arkivistikë ka vazhduar të jetë i pranishëm edhe në fillim të viteve '70 për arsye të mungesës së një shkolle profesionale të arkivistikës dhe mungesës së traditës të kultivimit të arkivistikës si profesion. Numri i të punësuarve në arkiv ka vazhduar të rritet. Në vitin 1975 në Kosovë kanë qenë të punësuar gjithsej 91 arkivistë.¹⁰

Trajnimi dhe certifikimi i punëtorëve arkivorë nga viti 1970 deri në ditët e sotme

Trajnimi sistematik i arkivistëve në ish-Jugosllavi është ndërmarrë fillimisht nga Arkivi i Serbisë, duke organizuar kurse për arkivistikë që kanë zgjatur gjashtë muaj dhe janë mbajtur çdo vit. Punëtorët e institu-

⁷ Jusuf Osmani, *Seminarët e deritashme të Arkivit të Kosovës dhe të Shoqatës së Punonjësve Arkivorë të Kosovës me regjistatura dhe këshillime me punonjësit arkivorë (1960-1986)*, *Vjetar*, nr. 21-22, 1986, f. 423-438

⁸ Universiteti i Prishtinës, *Historiku i Universitetit të Prishtinës*, 2020. Shikuar më 10.08.2021. <https://fxm.uni-pr.edu/Universiteti/Historiku.aspx>

⁹ Ismet Dermaku, *Ocena izvršenja petogodišnjeg programa razvoja arhivske službe SAP Kosovo 1971-1975 i petogodišnji program razvoja arhivske službe SAP Kosovo 1976-1980*, *Zajednica Arbina Srbije i Kosova*, 1975, f. 1-3

¹⁰ Po aty f. 1-3

cioneve arkivore në Kosovë kanë marrë pjesë në këto kurse profesionale në periudhën pesëvjeçare nga viti 1970-1975. Nga gjithsej 91 punëtorë, 43 prej tyre e kanë përfunduar me sukses kursin e arkivistikës dhe janë pajisur me diplomë. Nga këta punëtorë, 21 prej tyre kanë qenë me përgatitje universitare, 17 me shkollë të lartë dhe 39 me shkollim të mesëm.¹¹ Në programin gjashtëmujor kandidatët kanë pasur mundësi të ndjekin ligjërata në lëndët si në vijim: Arkivistika praktike; Historia nacionale; Organizmi qeveritar dhe historia e institucioneve në Serbi; Shkrimi cirilik; Gjuhë ruse; Punë administrative; Legjislatura arkivore; Informatika; Rregullimi shoqëror i Republikës Socialiste të Jugosllavisë; Organizmi i punës në arkivat e Serbisë. Në fund të gjithë kandidatët u janë nënshtruar testeve dhe janë pajisur me diploma.¹²

Këto iniciativa kanë luajtur rol shumë të rëndësishëm për ngritjen profesionale të kuadrit të Arkivit të Kosovës. Në fillim të viteve '80 në Arkivin e Kosovës janë siguruar thujtë të gjitha kuadrot e nevojshme për profile të ndryshme që ishin të nevojshme për një arkiv bashkëkohor të kohës. Në këtë kohë në Arkivin amë kanë punuar 30 arkivistë dhe ndihmës arkivistë, prej të cilëve dy doktorë shkencash dhe tre punëtorë me nivel master të edukimit.¹³ Shqetësimi kryesor i Arkivit të Kosovës ka qenë sigurimi i kuadrove profesionale në arkivat komunale, ndërkomunale dhe në regjistratura. Në fillim të viteve '80 Arkivi i Kosovës ka marrë vendim që çdo vit të organizojë kurse dymujore për punëtorët e inkuadruar në regjistratura. Qëllimi kryesor i organizimit të kursit arkivor ka qenë aftësimi profesional i punëtorëve që punojnë në arkiva, ente, institucione, organe shtetërore për ruajtjen, mbrojtjen, evidentimin, klasifikimin e materialit arkivor. Në këto kurse është zhvilluar programi teorik dhe praktik.¹⁴

Programi i kursit arkivor ka qenë shumë mirë i organizuar. Vijuesit kanë pasur mundësi të aftësohen për evidentimin dhe mbajtjen e librave të protokollit, regjistrimin e lëndëve, librat internë, të postës, faturave, librit arkivor, po ashtu ta bëjnë hartimin e shkresave, regjistrimin e lëndëve, arkivimin dhe klasifikimin e lëndës arkivore deri te dorëzimi i saj në afatin e caktuar tek arkivi kompetent. Përveç kësaj, në këtë kurs janë shtjelluar edhe dispozitat ligjore administrative të cilat rregullojnë çështjen e mbrojtjes së lëndës arkivore dhe në përgjithësi veprimtarinë përkitazi me korrespondencën zyrtare, si rregullimin dhe klasifikimin e lëndës arkivore në regjistratura, përpunimin, sistematizimin e lëndës në

¹¹ Po aty f. 1-3

¹² Srdjan Pejovic, Communication by e-mail, March 22, 2021

¹³ Gazmend Berisha, *Disa forma të ngritjes profesionale në veprimtarinë arkivore KSAK, Vjetar*, nr. 14-15, 1982, f. 395-397

¹⁴ Po aty f. 395-397

arkiv pas ndarjes nga materiali regjistraturik, mbrojtjen e lëndës arkivore në rast lufte: konservimin, restaurimin, mikrofilmimin e saj. Po ashtu, është diskutuar për arkivat në botë dhe për rëndësinë e arkivit në kulturë dhe shkencë.¹⁵

Këto kurse profesionale Arkivi i Kosovës i ka organizuar nga viti 1980, kurset janë mbajtur në ndërtesën e Arkivit. Kursi i parë i arkivistikës ka filluar më 01.10.1980 dhe ka zgjatur dy muaj. Pjesëmarrës në këtë kurs ishin 44 persona. Në muajin e parë pjesëmarrësit kanë vijuar në mënyrë intensive ligjëratat nga lëndët: Arkivistika, Rregullim shtetëror RSFJ, Dispozitat ligjore mbi lëndën arkivore dhe shërbimin arkivor, Korrespondencë zyrtare dhe Histori. Në muajin e dytë pjesëmarrësit kanë pasur mundësi të mbajnë punë praktike në Arkivin e Kosovës. Ata, po ashtu, kanë marrë pjesë në këshillimin e punëtorëve arkivorë të organizuar në Brezovicë. Në fund të gjithë kursistët u janë nënshtruar provimeve me gojë dhe me shkrim. Kandidatët që kanë kaluar provimet me sukses janë pajisur me certifikatë.¹⁶ Në mënyrë periodike Arkivi i Kosovës ka vazhduar të organizojë Kursin Profesional të Arkivistikës për çdo vit. Është e rëndësishme të ceket që përgjatë viteve planprogrami i kursit ka pësuar ndryshime si, për shembull, në Kursin Profesional për Ndihmës-arkivist të vitit 1985/1986 është shtuar lënda Shkencat Ndihmëse (Informatika, Fotografonika, Paleografia) dhe në fund të kursit pjesëmarrësit, përveç provimeve me shkrim, kanë punuar edhe seminare.¹⁷

Arkivi i Kosovës në vitin 1986/1987 ka organizuar Kursin e Arkivistikës për punëtorët që kanë punuar në shkrimore dhe arkiva të regjistraturave. Në këtë kurs kanë qenë pjesëmarrës 35 punëtorë. Kursi ka filluar më 24.11.1986 dhe ka zgjatur rreth dy muaj. Lëndët të cilat janë ligjëruar në këtë kurs janë si në vijim: Arkivistika, Arkivistika në gjuhën serbo-kroate, Afarizëm zyrtar, Histori në gjuhën shqipe, Histori në gjuhën serbo-kroate, Rregullim shtetëror në gjuhën shqipe, Rregullim shtetëror në gjuhën serbo-kroate. Pjesëmarrësit të cilët i kanë kaluar me sukses provimet janë pajisur me certifikatë.¹⁸

Vitet '90 karakterizohen me një situatë politike të rënduar, e cila ndikoi edhe në zhvillimin normal të aktiviteteve të institucioneve arkivore për arsye se si pasojë e masave të dhunshme një pjesë e konsiderueshme e stafit u largua nga puna. Pas çlirimit të vendit në vitin 1999, gradualisht çdo gjë filloi t'i kthehet normalitetit, po ashtu dhe institucioni i Arkivit të Kosovës filloi aktivitetet.

¹⁵ Po aty f. 395-397

¹⁶ Arkivi i Kosovës, *Fondi i Arkivit*, ditarët e vitit 1981, Prishtinë

¹⁷ Arkivi i Kosovës, *Fondi i Arkivit*, ditarët e vitit 1982/1985/1986, Prishtinë

¹⁸ Arkivi i Kosovës, *Fondi i Arkivit*, ditarët e vitit 1986/1987, Prishtinë

Në vitin 2001 Arkivi i Kosovës ka organizuar kursin me punëtorët arkivorë nga 15 deri më 26 tetor. Në planprogramin e kursit janë përfshirë pjesa teorike dhe praktike. Në këtë kurs janë ligjëruar një sërë temash gjithëpërfshirëse nga lëmi i arkivistikës, duke filluar nga kornizat ligjore, historikut të arkivave në vend dhe botë, arkivistika si shkencë e veçantë, materiali arkivor, llojet e arkivave, materialet regjistraturike, organizmi dhe drejtimi i punës në arkiva, ekspertiza e vlerës dhe ruajtjes së dokumenteve, pranimi i lëndës arkivore në arkiv, organizmi i depove, dokumentet arkivore jashtë arkivit, rregullimi dhe regjistrimi i materialit arkivor, specifikat e punimit dhe përpunimit të llojeve të veçanta të fondeve dhe koleksioneve, materialet arkivore të UÇK-së, shërbimi informativ në arkiv, publikimi i lëndës arkivore, posaçërisht është ligjëruar mbi zbatimin e standardeve ndërkombëtare të arkivistikës të ofruara disa kohë më parë nga Këshilli Ndërkombëtar i Arkivave, siç janë: Normat e përgjithshme ndërkombëtare për regjistrimin arkivor ISAD/G (General Standard Archival Description); Standardet ndërkombëtare për dokumentin arkivor për krijuesit e lëndës arkivore - personat juridikë, privatë dhe familjet ISAAR/CPF; Udhërrëfyesi për administrimin e dokumentacionit elektronik nga perspektiva arkivore; Drejtimet e shfrytëzimit të informatave elektronike. Ligjërues ishin punëtorët arkivorë e shkencorë të Arkivit të Kosovës dhe arkivave rajonale, nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave të Shqipërisë, të Departamentit të Kulturës, dhe nga zyrtarë të SOROS-it i cili ishte financues i organizimit të kursit. Duhet theksuar se nevoja për të organizuar një kurs të tillë ka qenë e domosdoshme për shkak se në Arkivin e Kosovës pas luftës janë punësuar një numër i konsiderueshëm i kuadrove të reja, gjithashtu është kthyer në punë stafi që ishte larguar nga masat e dhunshme serbe. Pjesëmarrësit ishin arkivistët dhe ndihmësarkivistët nga: Arkivi i Kosovës, arkivat rajonale dhe komunale që janë në gjithë vendin. Përveç anës teorike, në këtë kurs janë demonstruar edhe shembuj praktikë.¹⁹ Një vit më vonë, në vitin 2002, është organizuar kursi i parë profesional me certifikim nga datat 1 tetor- 4 dhjetor. Në muajin e parë janë mbajtur ligjëratat, ndërsa në muajin e dytë është kryer pjesa praktike për pjesëmarrësit. Arkivi i Kosovës e ka organizuar këtë kurs në bazë të nenit 25 dhe 29 të Rregullores për organizimin e kursit dymujor për aftësim profesional. Në fund të kursit pjesëmarrësit, që ishin kryesisht kuadro të reja të punësuar në institucionet arkivore, u janë nënshtruar provimeve me shkrim dhe nëse janë treguar të suksesshëm, janë certifikuar si arkivistë dhe ndihmësarkivistë.²⁰

¹⁹ Gazmend Berisha, *Nga veprimtaria e Arkivit të Kosovës*, *Vjetar*, nr. 29-30, 2003, f. 583-592

²⁰ Habibe Qovani, *Dosje personale - certifikatë*, 2003

Kurse profesionale me certifikim nuk janë organizuar më deri në vitin 2009 kur Arkivi i Kosovës, në bazë të Ligjit mbi Lëndën Arkivore dhe Arkivat (Ligj nr. 2003/7) si dhe duke e parë të nevojshëm aftësimin e kuadrove të reja si në Agjencinë Shtetërore të Arkivave të Kosovës, po ashtu edhe në institucionet e tjera publike të Republikës së Kosovës, ka organizuar “Kursin me arkivistët e institucioneve shtetërore të Republikës së Kosovës”. Qëllimi i kursit ishte aftësimi i kuadrit që punon në arkiva/shkrimore të institucioneve shtetërore të Kosovës për menaxhimin e dokumenteve arkivore në letër dhe në formën digjitale. Nevoja për organizimin e një kursi të tillë ka ardhur si pasojë e punësimit të stafit të ri i cili nuk ka përvojë pune me dokumente arkivore, nuk njeh risitë në menaxhimin zyrtar të dokumenteve, sidomos futjen e standardeve të reja ndërkombëtare dhe krijimin e dokumenteve të reja në formë elektronike. Kursi është organizuar gjatë muajve maj-qershor 2009 dhe ka përfshirë gjithsej 168 orë mësimi. Planprogrami i kursit ka qenë i ndarë në dy pjesë: teorike dhe praktike. Gjatë kursit janë ligjëruar lëndët si në vijim: Menaxhimi zyrtar klasik (në letër); Menaxhimi zyrtar elektronik (digjital); Arkivistika; Informatika - kompjuterizim; Legjislacioni arkivor dhe zyrtar. Ndërsa për ta plotësuar pjesën teorike janë mbajtur orë praktike mësimore dhe janë demonstruar shembuj praktikë për lëndët si në vijim: Menaxhimi zyrtar në letër; Menaxhimi zyrtar elektronik; Arkivistikë. Ky kurs ka qenë i hapur për zyrtarë arkivorë nga institucione të ndryshme siç janë Kuvendi, Presidenca, Zyra e Kryeministrit, ministritë dhe agjencitë. Ligjërues ishin arkivistët profesionalë nga Agjencia Shtetërore e Arkivave e Kosovës, po ashtu edhe ekspertë dhe profesorë nga Universiteti i Prishtinës. Numri i kandidatëve për këtë kurs ka qenë i kufizuar në 20 kandidatë, të cilët në fund të kursit janë obliguar t’u nënshtrohen provimeve me shkrim për secilën lëndë dhe ata të cilët kanë treguar sukses në provime janë certifikuar.²¹

Po ashtu, më 8 tetor 2009 Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës, në bazë të nenit 38 të Ligjit për Lëndën Arkivore dhe Arkivat (Ligj nr. 2003/7), ka nxjerrë Rregulloren për dhënien e provimit profesional në shërbimin arkivor të Kosovës dhe në bazë të saj ka organizuar një trajnim njëjavorë për përgatitjen e punëtorëve për dhënien e provimit profesional për arkivist dhe ndihmës-arkivist. Në bazë të Ligjit për Lëndën Arkivore dhe Arkivat (Ligji nr. 2003/7), të gjithë punëtorët arkivorë janë obliguar që në afatin për një vit ta fitojnë titullin përkatës arkivor. Për punëtorët të cilët janë me shkollim të mesëm është mbajtur parapërgatitja për provimin për ndihmës arkivist në lëndët si në vijim: Arkivistika, Mena-

²¹ Arkivi i Kosovës, *Fondi i Arkivit, programi i kursit me arkivistët e institucioneve shtetërore të Republikës së Kosovës*, Prishtinë, 2009

xhimi zyrtar klasik dhe elektronik, Sistemet e informimit dhe arkivistika digjitale, Rregullimi shtetëror dhe administrativ dhe legjislacioni arkivor në Kosovë. Ndërsa për punëtorët që kanë pasur shkollim më superior është mbajtur parapërgatitja dhe provimi për arkivist në lëndët si në vijim: Arkivistika, Menaxhimi zyrtar klasik dhe elektronik, Sistemet e informimit dhe arkivistika digjitale, Rregullimi shtetëror dhe administrativ dhe legjislacioni arkivor në Kosovë, dhe Gjuhë e huaj. Pas përfundimit të ligjëratave të gjithë vijuesit, që ishin 32, janë pajisur me literaturën profesionale për të gjitha lëndët mësimore. Këta kandidatë u janë nënshtruar provimit me shkrim dhe kanë qenë të obliguar të përgatitin një punim seminari. Puna praktike profesionale është kryer në arkivin përkatës dhe është mbikëqyrur nga udhëheqësi i arkivit. Ligjërues kanë qenë persona me kualifikim të lartë shkollor, që ishin kryesisht profesorë universitarë. Provimet profesionale i ka zbatuar Këshilli për Dhënie e Provimit Profesional Arkivor në Kosovë. Këshilli është përbërë nga tre profesionalistë të fushës, të cilët kanë pasur përgjegjësi t'i vlerësojnë kandidatët në provimet me shkrim për secilën lëndë me "kalon" (nëse tregon rezultat) dhe "nuk kalon" (nëse nuk tregon rezultat). Kandidatët kanë pasur të drejtë për riprovim për secilën lëndë.²²

Agjencia Shtetërore e Arkivave e Kosovës kursin e fundit me certifikim e ka organizuar në muajt tetor-dhjetor 2018. Ky kurs është organizuar në bazë të nenit 5, pika e 4 e Ligjit për Arkivat Shtetërore (Ligji nr. 04/L-088) dhe Nenit 2, pika e 1 e Rregullores për organizimin e kurseve dhe certifikimin për zyrtarë arkivorë. Kjo iniciativë është ndërmarrë duke pasur parasysh nevojën për t'i certifikuar punëtorët e rinj të cilët janë punësuar ndër vite. Plani mësimor i kursit është ndarë në pjesën teorike dhe praktike. Në disa lëndë teoria dhe praktika janë ndërlidhur përgjatë gjithë kursit, ndërsa në disa të tjera praktika është mbajtur në përfundim të programit. Lëndët e ligjëruara në këtë kurs janë si në vijim: Legjislacioni arkivor dhe rregullimi shtetëror, Arkivistikë, Menaxhim zyrtar, Sistemet informative dhe arkivat digjitale, dhe Gjuhë e huaj angleze. Ligjërues në këtë kurs kanë qenë arkivistë dhe zyrtarë nga Agjencia Shtetërore e Arkivave e Kosovës, por janë angazhuar edhe profesorë universitarë të Universitetit të Prishtinës. Këtë kurs e kanë vijuar 23 arkivistë të rinj të cilët në përfundim të programit i janë nënshtruar provimit profesional dhe në bazë të suksesit të treguar janë certifikuar si arkivistë.²³

²² Agjencia Shtetërore e Arkivave e Kosovës, *Fondi i Arkivit, rregullore për dhënie e provimit profesional në shërbimin arkivor në Kosovë*, Prishtinë, 2009

²³ Agjencia Shtetërore e Arkivave e Kosovës, *Fondi i Arkivit, kursi i arkivistikës*, Prishtinë, 2018

Seminaret dhe konferencat e organizuara ndër vite nga Arkivi i Kosovës

Arkivi i Kosovës, përveç kurseve të arkivistikës organizuar që nga themelimi, në mënyrë të vazhdueshme ka organizuar edhe seminare me tema të ndryshme. Seminaret janë shfrytëzuar si formë mjaft efikase për aftësimin e kuadrove profesionale për arkiva, regjistratura dhe për zyra të institucioneve të ndryshme shtetërore.

Seminarin e parë profesional institucioni i arkivit e ka organizuar në vitin 1960 në Prishtinë. Tema e këtij seminari ishte “Marrëdhëniet në mes të arkivave shtetërore dhe regjistraturave”. Seminaret të shumta janë organizuar çdo vit, por në këtë punim do të përmend vetëm disa prej tyre. Në vitin 1968 në Prishtinë është organizuar Këshillimi me përfaqësuesit e arkivave komunale dhe ndërkomunale të formuara dhe me përfaqësuesit e disa organizatave dhe institucioneve. Në këtë seminar janë paraqitur zyrtarët me tema të ndryshme për lëmin e arkivistikës. Menjëherë pas këtij seminari është mbajtur Kuvendi Themelues i Shoqatës së Punëtorëve Arkivorë të Kosovës. Që nga themelimi Shoqata ka qenë bashkëorganizatore për seminare të shumta të cilat kanë pasur për qëllim afirmimin e kuadrove arkivore në vend. Përveç Arkivit të Kosovës, seminare dhe këshillime kanë organizuar edhe arkivat ndërkomunale dhe komunale në mënyrë vetjake për punëtorët e tyre. Në nëntor të 1977-s Arkivi i Mitrovicës, me ndihmën e Arkivit të Kosovës, ka organizuar seminarin dyditësh për regjistraturat mbi të cilat bën mbikëqyrjen.²⁴

Seminari i parë pas luftës është organizuar në vitin 2001, më 7-8 qershor në Prishtinë, me temën “Organizmi dhe funksionimi i shërbimit arkivor në Kosovë”. Ky seminar ishte i një rëndësie të veçantë për shkak se në qendër të vëmendjes të këtij seminari ishte mënyra e organizmit të shërbimit arkivor në Kosovën e shkatërruar nga lufta. Në këtë seminar kanë marrë pjesë ekspertë të fushës nga Shqipëria, përfaqësuesit nga të gjithë arkivat në Kosovë, përfaqësuesit e Institutit të Historisë, të Institutit Albanologjik dhe të Universitetit të Prishtinës. Në ditën e parë kanë marrë pjesë 150 pjesëmarrës, ndërsa në të dytën afër 120 pjesëmarrës. Arkivistë dhe njohës të fushës u paraqitën me tema të ndryshme. Këto tema u botuan në revistën “Vjetari”. Në këtë seminar u diskutua edhe për rëndësinë e trajnimit të kuadrit arkivor në Kosovë, po ashtu që organizmi i seminarit të vazhdojë për çdo vit.²⁵ Në vitin 2004 në

²⁴ Jusuf Osmani, *Seminaret e deritashme të Arkivit të Kosovës dhe të Shoqatës së Punonjësve Arkivorë të Kosovës me regjistratura dhe këshillime me punonjës arkivorë (1060-1986)*, *Vjetar*, nr. 21-22, 1986, f. 423-438

²⁵ Gazmend Berisha, *Seminar ndërkombëtar kushtuar shërbimit arkivor në Kosovë*, *Vjetar*, nr. 25-26, 2001, f. 449-452

Prishtinë është mbajtur seminari me punëtorët arkivorë të rajonit, në të cilin kanë marrë pjesë përfaqësues nga Sllovenia, Kroacia, Maqedonia, Shqipëria, Turqia dhe Kosova. Tema e këtij seminari ishte “Arkivat elektronike”.²⁶ Në vitin 2011, me organizmin e Agjencisë Shtetërore të Arkivave të Kosovës, në Shqipëri është mbajtur seminari me zyrtarët e institucioneve shtetërore dhe lokale me temën “Menaxhim zyrtar”. Në këtë seminar kanë marrë pjesë 82 pjesëmarrës. Tema kanë paraqitur arkivistë dhe njohës të fushës.²⁷

Në vitin 2016 Agjencia Shtetërore e Arkivave e Kosovës, në bashkëpunim me Kolegjin “Fama”, ka organizuar seminarin pesëditorë me temën “Menaxhimi dhe ruajtja e dokumenteve arkivore”, me fondkrijues të nivelit qendror dhe lokal të Republikës së Kosovës. Një pjesë e punimeve të këtij seminari u zhvilluan në Shqipëri.

Agjencia Shtetërore e Arkivave e Kosovës, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Shqipërisë, që nga viti 2017 për çdo vit vazhdon ta organizojë “Konferencën Ndërkombëtare të Arkivistikës” me tema të ndryshme për secilin vit. Organizmi i kësaj konference luan rol të rëndësishëm në afirmimin e zyrtarëve arkivorë. Në konferencë me kumtesa të ndryshme janë paraqitur arkivistët, zyrtarët dhe njohësit e fushës së arkivistikës nga të gjitha trojet shqiptare.²⁸

Arkivistika në sistemin formal të edukimit në Kosovë

Përtej zhvillimit të kurseve dhe seminareve në kuadër të Arkivit të Kosovës, arkivistika si lëmë ka qenë dhe është pjesë e programeve të ndryshme formale edukative. Në Kosovë arkivistika ka qenë program i veçantë në nivelin e mesëm formal edukativ në kuadër të OBPS (Organizata Bazë për Punë të Bashkuar) - Drejtimi për Veprimtari Kulturologjike. Ky program ka filluar në vitin shkollor 1982/83 dhe ka zgjatur gjashtë vjet shkollim. Në vitin shkollor 1982/83 në OBPB - Drejtimi për Veprimtari Kulturologjike - është paraqitur Dega Përkthyes, Arkivor dhe Muzeor. Lëndët kanë qenë pothuajse të njëjta në secilin vit shkollor dhe ato janë si në vijim: Gjuhë Shqipe dhe Letërsi; Gjuhë Serbo-kroate; Marksizëm; Edukatë fizike; Gjuhë Angleze; Gjuhë Frënge; Gjuhë Latine; Histori e civilizimit; Histori e artit, Filozofi; Psikologji; Sociologji; Kimi; Arkivistikë; Afarizëm zyrtar; Konservimi i materialit arkivor; Shërbimi zyrtar arkivor; Daktilografi; Bazat e informatikës. Në

²⁶ Gazmend Berisha, *Nga veprimtaria dhe aktivitetet e Arkivit të Kosovës - seminarët, Vjetar*, nr. 31-32, 2004, f. 567-590

²⁷ Jusuf Osmani, *Aktivitetet e Agjencisë Shtetërore të Arkivave të Kosovës, Vjetar*, nr. 45-46, 2011, f. 643-655

²⁸ Shpresa Mekaj, *Aktivitetet e Agjencisë Shtetërore të Arkivave të Kosovës, Vjetar*, nr. 53, 2017, f. 425

këtë drejtim kanë ligjëruar mësimdhënës të ndryshëm, në mesin e të cilëve ka pasur edhe punëtorë të Arkivit të Kosovës siç është prof. dr. Jusuf Osmani. Këtë drejtim, për aq kohë sa ka ekzistuar, deri në vitin shkollor 1988/89, e kanë përfunduar me sukses gjithsej 682 nxënës të cilët janë konsideruar të kualifikuar për të punuar si ndihmësarkivistë.²⁹ Që nga periudha e pasluftës dhe deri në ditët e sotme në kuadër të Shkollës Ekonomike dhe Juridike “Hoxhë Kadri Prishtina” në Drejtimin Juridik - Profili Asistent i Administratës - mësohet lënda Arkivistikë dhe veprimtari bibliotekare dhe mbahen modulet e praktikës profesionale për sa i përket lëmit të arkivistikës.³⁰

Interesimi dhe kërkesa për shkollim të kuadrit arkivor në Kosovë është e kahershme. Arkivistika si lëndë e veçantë ligjërohet në planprogram të studimeve bachelor të historisë në kuadër të Fakultetit Filozofik, ndërsa në studimet master, përveç arkivistikës, mësohet edhe lënda Sistemet informative dhe arkivat digjitale. Në Fakultetin Filozofik që nga viti 2014-2017 është akredituar programi master për Arkivistikë. Ky program është dedikuar për të gjithë studentët me kualifikime të ndryshme akademike të cilët kanë interes ta studiojnë arkivistikën. Në semestrin e parë në planprogram janë tri lëndë obliguese; Arkivistikë - teoria dhe praktika, Historia e arkivave në vend dhe botë, Menaxhimi zyrtar. Në radhët e lëndëve zgjedhore studenti ka pasur mundësi të zgjedhë: Historiku i institucioneve në Kosovë; Paleografi latine; Gjuhë dhe paleografi osmane. Në semestrin e dytë janë ligjëruar këto lëndë: Rregullimi dhe përpunimi i lëndës arkivore; Historia e civilizimit; Metodologjia e kërkimeve shkencore dhe arkivore. Lëndë zgjedhore: Legjislacioni arkivor; Informatika; Menaxhimi kompjuterik; Rregullimi i lëndës arkivore; Gjuhë angleze (frënge, gjermane, italiane). Në semestrin e tretë lëndë obliguese janë: Vlerësimi i lëndës arkivore; E-arkivat; Mbrojtja dhe ruajtja e trashëgimisë kulturore dhe arkivore. Lëndë zgjedhore janë: Historia publike dhe menaxhimi i programeve; Standardet ndërkombëtare të arkivistikës; Bazat e gjuhës sllave në Ballkan. Në semestrin e katërt studentët janë ngarkuar vetëm me pune mentorale. Në këtë semestër studentët kanë punuar temën e punimit master. Programi master i Arkivistikës në Fakultetin Filozofik ka 120 kredi, përafërsisht nga 60 për një semestër. Përveç ligjëratave dhe provimeve, në planprogram është përfshirë edhe puna praktike e cila është mundësuar me anë të protokollit

²⁹ Arkivi i shkollës “Eqrem Qabej”, *Fondi i Organizatës Bazë të Punës së Bashkuar - Drejtimi për Veprimtari Kulturologjike*, librat amë 1982/83, 1983/84, 1984/85, 1985/86, 1986/87, 1987/88, 1988/89, Prishtinë

³⁰ Katalog i shkollave profesionale të komunës së Prishtinës, komuna e Prishtinës, gusht 20, 2021, <http://c1940652.r52.cf0.rackcdn.com/56d814c4b8d39a3ca3000d73/KATALOG-I-PROFILEVE-T-SHKOLLAVE-PROFESIONALE.pdf>

të bashkëpunimit me Agjencinë Shtetërore të Arkivave të Kosovës. Këtë program të masterit për çdo vit e kanë ndjekur rreth 60 studentë të cilët, pas përfundimit me sukses të studimeve, janë përgatitur për kryerjen e pavarur të punës profesionale në arkivat shtetërore, speciale dhe private. Po ashtu, mund t'i ndjekin studimet e nivelit të doktoratës apo të punojnë në institucione shkencore hulumtuese.³¹ Programi master i Arkivistikës është akredituar sërish në vitin shkollor 2021/2022 për tre vjetët e ardhshëm.

Bashkëpunimi ndërkombëtar dhe pjesëmarrja në konferenca

Agjencia Shtetërore e Arkivave e Kosovës, në veçanti Departamenti për Politika Zhvillimore, vazhdimisht bën përpjekje për zhvillimin dhe rritjen e bashkëpunimit arkivor ndërkombëtar. Kjo punë është manifestuar me sukses për arritjen e shumë marrëveshjeve të bashkëpunimit me arkiva të ndryshme jashtë vendit dhe inkuadrimit në mekanizma ndërkombëtarë të arkivistikës. Pjesëmarrja në konferenca dhe vizitat studimore kanë rol të rëndësishëm për ngritjen e kapaciteteve dhe ngritjen profesionale të zyrtarëve arkivorë.

Në vitin 2001 Arkivi i Kosovës është pranuar anëtar i barabartë në Këshillin Ndërkombëtar të Arkivistikës, kategoria A, si arkiv kombëtar, pastaj në Këshillin “Memoria e Botës” në kuadër të UNESCO-s. Pas pranimit të Arkivit të Kosovës në Këshillin Ndërkombëtar të Arkivistëve dhe pjesëmarrjes së parë në CITRA 2002, në Marsej të Francës, përfaqësuesit e Arkivit të Kosovës kanë marrë pjesë në Konferencën Ndërkombëtare të Tryezës së Rrumbullakët të Arkivave (Conference Internationale de la Table Ronde des Archives), forumi vjetor i Këshillit Ndërkombëtar të Arkivave në tetor 2003, në Cape Town në Afrikën e Jugut. Në këtë konferencë, me temën “Arkivat dhe të drejtat e njeriut”, nga Kosova ka marrë pjesë Jusuf Osmani, ish-drejtor i Arkivit të Kosovës.

Agjencia Shtetërore e Arkivave e Kosovës në vitet në vazhdim ka marrë pjesë zyrtarisht në shumicën e konferencave dhe kongreseve të organizuara nga Këshilli Ndërkombëtar i Arkivistëve, Këshilli “Memoria e popullit” dhe Këshilli i Arkivistëve për Evropën. Një tjetër aktivitet i rëndësishëm për ngritjen e kapaciteteve të arkivistëve nga Kosova është pjesëmarrja në Shkollën e Arkivistikës të organizuar nga Instituti Ndërkombëtar i Arkivistikës në Trieste. Vite me radhë në këtë shkollë janë dërguar për shkollim arkivistë nga Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës të cilët, përveç ngritjes profesionale, kanë krijuar edhe përvoja

³¹ Bujar Dugolli, *Program i ri i studimeve në master Arkivistikë, Vjetar*, nr. 50, 2014, f. 23-63

ndërkombëtare dhe kanë pasur mundësi të krijojnë relacione profesionale me arkivistë nga shtete të ndryshme të botës.³²

Në vitin 2006, në kuadër të bashkëpunimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave pranë Kryeministrit të Turqisë dhe arkivave të Kosovës, është organizuar kursi për aftësimin e kuadrit për deshifrimin dhe leximin e dokumenteve në gjuhën osmane. Kursi është organizuar në lokalet e Arkivit të Kosovës nga 4 shtator-2 dhjetor. Në këtë kurs vijues ishin 27 kandidatë nga institucione të ndryshme të Kosovës. Ligjërues ishte prof. dr. Mustafa Kuçi, ekspert i orientalistikës nga Arkivi Osman në Stamboll. Kandidatët në fund u janë nënshtruar provimit dhe ata të cilët kanë treguar sukses janë pajisur me certifikatë.³³

Në radhët e pjesëmarrjes në shkolla dhe trajnime jashtë vendit është edhe pjesëmarrja e gjashtë arkivistëve nga Kosova në vitin 2008 në kursin profesional të arkivistikës të organizuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave të Shqipërisë. Kursi ka zgjatur një muaj dhe pjesëmarrësit u janë nënshtruar provimeve dhe kanë bërë paraqitjen e temës, pastaj janë pajisur me certifikatë.³⁴

Arkivistë dhe zyrtarë nga Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës kanë bërë vizita të ndryshme studimore në arkivat e vendeve të ndryshme si në Bosnjë dhe Hercegovinë, Turqi, Slloveni, Kroaci, Shqipëri, Mal të Zi, Bullgari, Francë dhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Konkluzione dhe rekomandime

Institucionet arkivore në Kosovë që nga themelimi e deri sot kanë punuar vazhdimisht për trajnimin e kuadrove që punojnë në Agjencinë Shtetërore të Arkivave të Kosovës dhe në zyra të institucioneve të ndryshme të nivelit qendror dhe lokal. Si rezultat i këtyre përpjekjeve në Agjencinë Shtetërore të Arkivave të Kosovës të gjithë punëtorët e kësaj agjencie janë treguar të suksesshëm në provimin profesional të arkivistikës dhe janë certifikuar, përjashtuar një numër të vogël të cilët janë punësuar vitet e fundit dhe ende nuk i janë nënshtruar provimit. Rekomandohet motivim dhe angazhim më gjithëpërfshirës i arkivistëve në trajnime, shkolla, konferenca, hulumtime, punëtori dhe shkëmbime përvojash në vend dhe jashtë vendit për arsye se ato janë mundësia më e mirë për ta rritur performancën e punëtorëve dhe për ta ndihmuar Agjencinë Shtetërore të Arkivave të Kosovës që të jetë në hap me zhvillimet ndërkombëtare në fushën e arkivistikës. Për sa iu përket limiteve të këtij

³² Gazmend Berisha, *Nga veprimtaria e Arkivit të Kosovës*, *Vjetar*, nr. 39-40, 2008, f. 637-645

³³ Po aty f. 587-598

³⁴ Po aty f. 587-598

studimi, më duhet të cek që, pavarësisht prej përpjekjes për të hulumtuar për Kursin e arkivistikës të mbajtur në vitin 2002, nuk kam arritur të gjej material të mjaftueshëm.

Referenca:

Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës. *Rregullore për dhënien e provimit profesional në shërbimin arkivor në Kosovë*. Fondi i Arkivit, Prishtinë, Agjencia Shtetërore e Arkivave e Kosovës, 2009

Arkivi i Kosovës. n.d., *Fondi i arkivit, ditarët e vitit 1981*, Prishtinë

Arkivi i Kosovës. n.d., *Fondi i arkivit, ditarët e vitit 1982*, Prishtinë

Arkivi i Kosovës. n.d., *Fondi i arkivit, ditarët e viti 1986/87*, Prishtinë

Arkivi i Kosovës. n.d., *Fondi i arkivit, ditarët e vitit 1985/86*, Prishtinë

Arkivi i Shkollës "Eqrem Qabej". n.d., *Librat amë - ditarët e vitit 1982/83, 1983/84, 1984/85, 1985/86, 1986/87, 1987/88, 1988/89*, Prishtinë: Organizata Bazë e Punës së Bashkuar për Veprimtari Kulturologjike

Berisha, Gazmend, *Aktivitetet e Arkivit të Kosovës, Vjetar* (Arkivi i Kosovës), nr. 35-36 (2006)

Berisha, Gazmend, *Disa forma të ngritjes profesionale në veprimtarinë arkivore në KSAK, Vjetar*, nr. 14-15 (1982)

Berisha, Gazmend, *Nga veprimtaria dhe aktivitetet e Arkivit të Kosovës, Vjetar*, nr. 31-32 (2004)

Berisha, Gazmend, *Nga veprimtaria e Arkivit të Kosovës, Vjetari*, nr. 29-30, (2003)

Berisha, Gazmend, *Seminar ndërkombëtar kushtuar shërbimit arkivor në Kosovë, Vjetar*, nr. 25-26 (2001)

Berisha, Gazmend, *Seminaret dhe këshillimet e organizuara nga Shoqata e Punonjësve Arkivorë të Kosovës, Vjetar*, nr. 16-17 (1982)

Dërmaku, Ismet, *Deset Godina Rada Pokrajniskog Državnog arhiva, Godišnjak*, nr. 1 (1965)

Dermaku, Ismet, *Ocena izvršenja petogodišnjeg programa razvoja arhivske službe SAP Kosovo 1971-1975 i petogodišnji program razvoja arhivske službe SAP Kosovo 1976-1980*, Zajednica Arhiva Srbije i Kosova, (1975)

Komuna e Prishtinës. *Katalog i profileve të shkollave profesionale në komunën e Prishtinës*, 2016, Accessed August 20, 2021 <http://c1940652.r52.cf0.rackcdn.com/56d814c4b8d39a3ca3000d73/KATALOG-I-PROFILEVE-T-SHKOLLAVE-PROFESIONALE.pdf>.

Maqedonci, Zaim, *Veprimtaria arkivore dhe detyrat e shërbimit amë të Arkivit të Kosovës, Vjetari*, nr. 2-3 (1970)

Osmani, Jusuf, *Seminaret e deritashme të Arkivit të Kosovës dhe të Shoqatës së Punonjësve Arkivorë të Kosovës me regjistatura dhe këshillime me punonjësit arkivorë (1960-1986), Vjetari*, nr. 21-22 (1986)

Osmani, Jusuf, *Arkivat dhe zhvillimi i shërbimit arkivor në Kosovë, Vjetari*, nr. 24 (1988)

Osmani, Jusuf, *Arkivistika - teoria dhe praktika*, Prishtinë, AShAK, 2005

Osmani, Jusuf, *Seminaret e deritashme të Arkivit të Kosovës dhe të Shoqatës së Punonjësve Arkivorë të Kosovës me regjistatura dhe këshillime me punonjës arkivorë (1960-1986), Vjetar*, nr. 21-22 (1986)

Rexha, Iljaz, *Shoqata e Punëtorëve Arkivorë të Kosovës, Vjetari*, (1974)

Universiteti i Prishtinës. n.d., *Historiku i Universitetit të Prishtinës*. Accessed 08 10, 2020. <https://fxm.uni-pr.edu/Universiteti/Historiku.aspx>